EW8F228S



SQ Lavatriçe

Udhëzimet për përdorim

Electrolux

PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË....3
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË....4
3. INSTALIMI....6
4. PËRSHKRIM I PRODUKTIT....9
5. PANELI I KONTROLLIT....9
6. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT....12
7. PROGRAMET....15
8. CILËSIMET....20
9. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË....20
10. PËRDORIMI I PËRDITSHËM....21
11. UDHËZIME DHE KËSHILLA....25
12. KUJDESI DHE PASTRIMI....26
13. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE....31
14. VLERAT E KONSUMIT....34
15. TË DHËNAT TEKNIKE....34
16. AKSESORËT....35

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.
Mirë se vini në Electrolux.
Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:
www.electrolux.com/webselfservice



Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:
www.registerelectrolux.com



Blini aksesorë, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:
www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë këmbimi origjinale.
Kur kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, Numri i serisë.
Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.

⚠ Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin

ⓘ Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ TË DHËNA PËR SIGURINË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria për fëmijët dhe personat vulnerabël

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Mos i lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Fëmijët e moshës 3 vjeç e poshtë duhet të mbahen gjithmonë larg nga kjo pajisje kur ajo është në punë.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ky duhet aktivizuar.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Mos tejkaloni ngarkesën maksimale prej 8 kg (referojuni kapitullit "Tabela e programeve").
- Presioni i punës i ujit në pikën e hyrjes së ujit nga lidhja e daljes duhet të jetë midis 0,5 bar (0,05 MPa) dhe 8 bar (0,8 MPa).

- Vrima e ajrimit në pjesën e poshtme nuk duhet të mbulohet nga tapeti, rrugica apo ndonjë mbulesë tjetër dyshemeje.
- Pajisja duhet të lidhet me furnizimin me ujë duke përdorur kompletin e ri të tubave që vjen me pajisjen ose komplete të tjera të reja tubash të ofruara nga qendra e autorizuar e shërbimit.
- Kompletet e vjetra të tubave nuk duhet të ripërdoren.
- Për të shmangur rreziqet elektrike, nëse kablloja elektrike është e dëmtuar, ajo duhet ndërruar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me një leckë të njomë. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra, tretës ose objekte metalike.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi

Instalimi duhet të jetë në përputhje me rregulloret përkatës kombëtare.

- Hiqni paketimin dhe bulonat e transportit.
- Mbajini bulonat e transportit në një vend të sigurt. Nëse pajisja do të transportohet në të ardhmen, ata duhet të vendosen për të bllokuar kazanin për të parandaluar dëmtimet e brendshme.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Mos e instaloni ose mos e përdorni pajisjen kur temperatura mund të jetë më e ulët se 0°C ose kur ekspozohet ndaj kushteve atmosferike.
- Zona e dyshemesë ku do të instalohet pajisja duhet të jetë e sheshtë, e qëndrueshme, rezistente ndaj nxehtësisë dhe e pastër.
- Sigurohuni që ndërmjet pajisjes dhe dyshemesë të qarkullojë ajër.
- Mos e instaloni pajisjen direkt mbi një piletë në dysheme.
- Rregullojini këmbëzat në mënyrë që mes pajisjes dhe dyshemesë të ketë hapësirë të mjaftueshme.
- Mos e instaloni pajisjen në një vend ku dera e pajisjes nuk mund të hapet plotësisht.
- Mos vendosni një enë për të grumbulluar ujin që mund të rrjedhë nën pajisje. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për t'u

siguruar se cilët aksesorë mund të përdoren.

2.2 Lidhja elektrike

- Pajisja duhet tokëzuar.
- Përdorni gjithmonë një prizë me tokëzim të instaluar mirë.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kabllo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllon elektrike. Nëse kablloja e furnizimit me energji duhet zëvendësuar, kjo duhet bërë nga Qendra jonë e autorizuar e shërbimit.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Mos e prekni kabllon kryesore ose spinën e rrymës me duar të lagura.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kablloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon duke e kapur nga spina.
- Kjo pajisje është në përputhje me direktivat E.E.C.

2.3 Lidhja e ujit

- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.
- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.
- Mos përdorni tuba zgjatues nëse tubi i furnizimit me ujë është tepër i shkurtër. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për zëvendësimin e tubit të furnizimit të ujit.
- Ju mund ta zgjasni tubin e shkarkimit maksimumi 400 cm. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për tub tjetër dhe për zgjatues.

2.4 Përdorimi

PARALAJMËRIM!
Rrezik plagosjeje, goditjeje elektrike, zjarri, djegieje ose dëmtimi të pajisjes.

- Kjo pajisje është vetëm për përdorim shtëpiak.
- Zbatoni udhëzimet e sigurisë në ambalazhin e detergjentit.
- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisje.
- Sigurohuni që të keni hequr të gjitha objektet metalike nga rrobat.
- Mos lani pëlhura që janë të ndotura shumë me vajra, graso apo substanca të tjera vajore. Kjo mund të dëmtojë pjesët prej gome të lavatriçes. Lajini paraprakisht këto pëlhura me dorë përpara se t'i ngarkoni në lavatriçe.
- Mos e prekni xhamin e derës gjatë kohës që një program është në punë e sipër. Xhami mund të nxehet.

2.5 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me një qendër të autorizuar shërbimi.
- Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale.

2.6 Eliminimi i pajisjes

PARALAJMËRIM!
Rrezik plagosjeje ose mbytjeje.


- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji dhe ai me ujë.
- Priteni kabllon e rrjetit elektrik pranë pajisjes dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar ngecjen e fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake brenda kazanit.
- Hidheni pajisjen në përputhje me kërkesat lokale për hedhjen e pajisjeve mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

3. INSTALIMI


PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

3.1 Heqja e paketimit


1. Hiqni veshjen e jashtme. Nëse është e nevojshme përdorni një prerëse.




2. Hiqni pjesën e jashtme prej kartoni dhe materialet prej polistireni të paketimit.




3. Hapni derën. Nxirrni të gjitha rrobat nga kazani.




4. Vendoseni elementin e përparmë paketues prej polistireni mbi dysheme poshtë pajisjes. Uleni me kujdes pajisjen, nga pjesa e pasme.




5. Hiqni mbrojtësen prej polistireni nga pjesa e poshtme. Vendoseni pajisjen pas në pozicion vertikal.



6. Hiqni kabllon e furnizimit me energji dhe zorrën e shkarkimit nga mbajtëset e zorrës. *Ka mundësi të shihni të derdhet ujë nga zorra e shkarkimit. Kjo ndodh sepse lavatriçja është testuar në fabrikë.*



7. Hiqni tre bulonat e transportit dhe nxirrni jashtë distancatorët plastikë.



Rekomandojmë që të mbani të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit për çdo rast kur ju duhet ta transportoni pajisjen.


3.2 Informacion për instalimin

1. Pozicionimi dhe nivelimi


Rregullimi i saktë i pajisjes në nivelim, parandalon dridhjen, zhurmën dhe lëvizjen e pajisjes gjatë kohës që është në përdorim.

1. Instalojeni pajisjen mbi një dysheme të fortë e të sheshtë. Pajisja duhet të jetë e niveluar dhe e palëvizshme. Kontrolloni që pajisja të mos prekë murin apo pajisje të tjera dhe që të ketë qarkullim të ajrit poshtë pajisjes.

2. Lironi ose shtrëngoni këmbëzat për të rregulluar nivelin. Të gjitha këmbët duhet të qëndrojnë mirë mbi dysheme.



8. Vendosni nëpër vrima tapat plastike që do të gjeni në qesen e manualit të përdorimit.




PARALAJMËRIM!
Mos vendosni karton, dru apo materiale të tjera poshtë këmbëzave të pajisjes për të rregulluar nivelin.

2. Zorra e furnizimit me ujë

KUJDES!
Sigurohuni që zorrët të mos kenë dëmtime dhe që të mos ketë rrjedhje nga vendet e bashkimit. Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e furnizimit me ujë është tepër e shkurtër. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për zëvendësimin e zorrës së furnizimit të ujit.

1. Lidhni zorrën e hyrjes së ujit me pjesën e pasme të pajisjes.



2. Pozicionojeni atë majtas ose djathtas në varësi të pozicionit të rubinetit të ujit.

Sigurohuni që zorra e hyrjes së ujit të mos jetë në pozicion vertikal.

3. Nëse është e nevojshme, lironi dadon unazë për ta vendosur në pozicionin e duhur.

4. Lidheni zorrën e furnizimit me ujë te një rubinet uji me fileto 3/4".


3. Kullimi i ujit

Zorra e shkarkimit duhet të qëndrojë në një lartësi jo më të vogël se 60 cm dhe jo më të madhe se 100 cm.


Ju mund ta zgjasni zorrën e shkarkimit maksimumi 400 cm. Kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit për zorrë tjetër shkarkimi dhe për zgjatues.

Zorra e shkarkimit mund të lidhet në mënyra të ndryshme:

1. Bëni një formë U-je me zorrën e shkarkimit dhe vendoseni rreth udhëzuesit prej plastike.




2. **Në cepin e një lavamani** - Shtrëngojeni udhëzuesin me rubinetin e ujit ose në mur.




Sigurohuni që udhëzuesi plastik të mos lëvizë kur pajisja shkarkon dhe fundi i zorrës së shkarkimit të mos jetë i zhytur në ujë. Mund të kthehet ujë i ndotur brenda në pajisje.

3. Nëse fundi i zorrës të shkarkimit duket kështu (shihni figurën), mund ta shtyni direkt në tub.




4. **Në një tub vertikal me vrimë ajrimi** - Fusni zorrën e shkarkimit direkt në një tub shkarkimi. Referojuni figurës.




Gryka e zorrës së shkarkimit duhet të ajroset gjithmonë, pra diametri i brendshëm i tubit të shkarkimit (min. 38 mm - min. 1,5") duhet të jetë më i madh se diametri i jashtëm i zorrës së shkarkimit.

5.**Pa udhëzuesin e zorrës plastike, me një spigotë për lavaman** - Vendoseni zorrën e shkarkimit në spigotë dhe sigurojeni me një fashetë. Referojuni figurës.




Sigurohuni që zorra e shkarkimit të krijojë një hark për të parandaluar që copëzat të futen në pajisje nga lavamani.

6. Pozicionojeni zorrën **direkt në një tub shkarkimi të futur në murin e dhomës**dhe shtrëngojeni me fashetë.



4. PËRSHKRIM I PRODUKTIT

4.1 Pamje e përgjithshme e pajisjes



1. Pjesa e sipërme
2. Foleja e detergjentit
3. Paneli i kontrollit
4. Doreza e derës
5. Etiketa e specifikimeve
6. Filtri i pompës së shkarkimit
7. Këmbët për nivelimin e pajisjes
8. Tubi i shkarkimit
9. Lidhja e tubit të futjes së ujit
10. Kablloja e furnizimit me energji
11. Bulonat e transportit
12. Suporti i tubit


5. PANELI I KONTROLLIT

5.1 Veçoritë speciale

Lavatriçja juaj e re plotëson të gjitha kërkesat bashkëkohore për trajtimin efektiv të rrobave me konsum të vogël uji, energjie dhe detergjenti dhe tregon kujdes për rrobat.


- Teknologjia **Oko-Mix** është projektuar për të mbrojtur fibrat e rrobave falë fazave përpara përzierjes që tretin fillimisht detergjentin dhe më pas zbutësin e rrobave në ujë përpara se të shpërndahen nëpër rroba. Prandaj, kushtohet kujdes për çdo fibër.
- Opsioni **Njolla** i trajton paraprakisht njollat e forta duke optimizuar efikasitetin e heqësit të njollave.
- Falë opsionit **E butë Plus**, zbutësi i rrobave shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme në rroba dhe depërton thellë fibrat e rrobave duke favorizuar një butësi të përkryer.
- **Sistemi SensiCare** zbulon sasinë e ngarkesës së rrobave dhe përcakton kohëzgjatjen e programit brenda 30 sekondash. Programi i larjes është përshtatur në bazë të llojit dhe ngarkesës së rrobave pa konsumuar më shumë kohë, energji dhe ujë sesa nevojitet.

5.2 Përshkrimi i panelit të kontrollit



1 Çelësi i programeve
2 Butoni me prekje i opsioneve të reduktimit të centrifugimit
3 Temperatura butoni me prekje
4 Ekrani
5 Shtyrja butoni me prekje
6 Rregulluesi i kohës butoni me prekje
7 Start/Pause butoni me prekje
8 Natë butoni me prekje
9 Hekurosje e lehtëbutoni me prekje
10 E butë Plus butoni me prekje
11 Shpëlarje shtesë butoni me prekje
12 Njolla butoni me prekje
13 Paralarje butoni me prekje
14 Ndezje/Fikje butoni me shtypje

5.3 Ekrani



88 --*	Zona e temperaturës: Treguesi i temperaturës Treguesi i ujit të ftohtë
	Treguesi i bllokimit të sigurisë për fëmijët.
	Treguesi i shtyrjes së programit.
	Treguesi i derës së bllokuar.
0:00	Treguesi dixhital mund të tregojë: • Kohëzgjatja e programit (p.sh. 2:40). • Koha e shtyrjes (p.sh. 2h). • Përfundimi i ciklit (0:00). • Kodi i paralajmërimit (p.sh. E20).
-----	Treguesi i nivelit të shiritave të Rregulluesit të kohës.
88.8kg	Treguesi i peshës maksimale të rrobave. **MAX** Ai pulson kur ngarkesa e rrobave tejkalon ngarkesën maksimale të deklaruar të programit të përzgjedhur.
	Treguesi i shtimit të rrobave. Ndizet në fillim të fazës së larjes, ndërsa përdoruesi mund ta vendosë ende në pauzë pajisjen dhe të shtojë më shumë rroba.
	Treguesi i pastrimit të kazanit.
	Treguesi Natë.
	Treguesi i ndërprerjes së shpëlarjes.

1888 – – –	Zona e centrifugimit: Treguesi i shpejtësisë së centrifugimit Treguesi Pa centrifugim. Faza e centrifugimit është çaktivizuar.
MIX	Treguesi Oko-Mix.

6. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT

6.1 Hyrje

Opsionet/funksionet nuk janë të disponueshme për gjithë programet e larjes. Kontrolloni përputhshmërinë midis opsioneve/funksioneve dhe programeve të larjes në "Tabelën e programeve". Një opsion/funksion mund të përjashtojë një tjetër, në këtë rast pajisja nuk ju lejon të vendosni opsione/funksione të papajtueshme.

6.2 Ndezje/Fikje

Shtypni këtë buton për pak sekonda për të aktivizuar ose çaktivizuar pajisjen. Dëgjohen dy tinguj të ndryshëm gjatë ndezjes ose fikjes së pajisjes.

Ndërsa funksion i Pritjes aktive e çaktivizon automatikisht pajisjen pas disa minutash për të ulur konsumin e energjisë, mund t'ju nevojitet ta aktivizoni sërish pajisjen.

Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Pritja aktive" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".

6.3 Temperatura

Kur përzgjidhni një program larjeje, pajisja propozon automatikisht një temperaturë të parazgjedhur.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet vlera e dëshiruar e temperaturës në ekran.

Kur ekrani shfaq treguesit _ _*, pajisja nuk e ngroh ujin.

6.4 Centrifugimi

Kur vendosni një program, pajisja vendos automatikisht shpejtësinë maksimale të lejuar të centrifugimit përveç programit Denim. Me këtë opsion ju mund të ndryshoni shpejtësinë e parazgjedhur të centrifugimit.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur që të:

- **Ulni shpejtësinë e centrifugimit.** Ekrani tregon vetëm shpejtësitë e disponueshme të centrifugimit për programin e vendosur.
- Aktivizoni opsionin **Pa centrifugim – – –**.
  Vendosni këtë opsion për të çaktivizuar të gjitha fazat e centrifugimit. Pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit të programit të zgjedhur të larjes. Vendosni këtë opsion për pëlhura shumë delikate. Faza e shpëlarjes përdor më shumë ujë për disa programe larjeje. Ekrani shfaq treguesin **– – –**.
- Aktivizoni opsionin **Ndërprerje e shpëlarjes**.
  Nuk është kryer centrifugimi i fundit. Uji i shpëlarjes së fundit nuk do të shkarkohet për të evituar zhubrosjen e rrobave. Programi i larjes përfundon me ujë në kazan.
  Ekrani shfaq treguesin . Dera qëndron e kyçur dhe kazani rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Për të zhbllokuar derën duhet të shkarkoni ujin.
  Në përfundim të programit, prekni butonin Start/Pause: pajisja kryen një fazë centrifugimi dhe shkarkon ujin.

Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

6.5 Paralarje

Me këtë opsion mund të shtoni një fazë paralarjeje te një program larjeje.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

- Përdoreni këtë funksion për të shtuar një fazë paralarjeje në 30 °C përpara fazës së larjes.
  Ky opsion rekomandohet për rrobat e ndotura shumë, veçanërisht nëse përmbajnë rërë, pluhur, baltë dhe grimca të tjera të ngurta.

Opsionet mund të rrisin kohëzgjatjen e programit.

6.6 Njolla

Prekeni këtë buton për të shtuar fazën e njollave në një program.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Përdoreni këtë opsion për rroba që kanë njolla të vështira për t'u hequr.

Kur vendosni këtë opsion, hidhni heqësin e njollave në ndarje .

Heqësi i njollave përzihet paraprakisht dhe ngrohet me detergjentin për të përmirësuar efikasitetin e vet.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.
Ky opsion nuk është i disponueshëm me një temperaturë më të ulët se 40°C.

6.7 I përhershëm Shpëlarje shtesë

Me këtë opsion mund të shtoni disa shpëlarje sipas programit të zgjedhur të larjes.

Përdoreni këtë opsion për personat me alergji ndaj mbetjeve të detergjentit dhe me lëkurë të ndjeshme.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet dhe qëndron gjithashtu i ndezur gjatë cikleve të mëvonshme derisa ky opsion të çaktivizohet.

6.8 I përhershëm E butë Plus

Vendosni këtë opsion për të optimizuar shpërndarjen e zbutësit të rrobave dhe për të përmirësuar butësinë e rrobave.

Rekomandohet kur përdorni zbutësin e rrobave.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet dhe qëndron gjithashtu i ndezur gjatë cikleve të mëvonshme derisa ky opsion të çaktivizohet.

6.9 Hekurosje e lehtë

Pajisja lan dhe centrifugon rrobat me kujdes për të parandaluar krijimin e rrudhave.

Pajisja e ul shpejtësinë e centrifugimit, përdor më shumë ujë dhe e përshtat kohëzgjatjen e programit sipas llojit të rrobave.

Treguesi përkatës ndizet.

6.10 Natë

Prekeni këtë buton për të aktivizuar/çaktivizuar opsionin **Natë** .

Të gjitha fazat e centrifugimit të ndërmjetme dhe përfundimtare anulohen dhe programi përfundon me ujë në kazan. Kjo ndihmon për të reduktuar rrudhosjen.

Ekrani shfaq treguesin . Dera qëndron e bllokuar. Kazani rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Për të zhbllokuar derën duhet të shkarkoni ujin.

Duke qenë se programi është shumë i heshtur, është i përshtatshëm për t'u përdorur gjatë natës kur disponohen edhe tarifa më të lira për energjinë elektrike. Në disa programe, shpëlarjet kryhen me më shumë ujë.

Nëse prekni butonin Start/Pause ▷‖, pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit.

Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

6.11 Shtyrja

Me këtë opsion mund ta shtyni fillimin e programit deri në një kohë më të të volitshme.

Prekni në mënyrë të përsëritur butonin për të vendosur shtyrjen e kërkuar. Koha rritet me hapa prej 1 ore deri në 20 orësh.

Pas prekjes së butonit Start/Pause ▷‖, ekrani shfaq treguesin dhe pajisja fillon numërimin mbrapsht dhe dera kyçet.

6.12 Rregulluesi i kohës

Me këtë opsion mund të reduktoni kohëzgjatjen e programit në varësi të madhësisë së ngarkesës dhe nivelit të ndotjes.

Kur vendosni një program larjeje, ekrani tregon kohëzgjatjen e parazgjedhur dhe ––––– vijëza.

Prekni butonin Rregulluesi i kohës për të reduktuar kohëzgjatjen e programit sipas nevojave tuaja. Ekrani shfaq kohëzgjatjen e re të programit dhe një numër vijëzash do të ulen përkatësisht:

–––– e përshtatshme për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje normale.

––– një cikël i shpejtë për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje të vogël.

–– cikël shumë i shpejtë për ngarkesë me ndotje shumë të vogël (rekomandohet maks. një gjysmë ngarkese).

– cikli më i shkurtër për të freskuar një sasi të vogël rrobash.

Opsioni Rregulluesi i kohës është i disponueshëm vetëm me programet në tabelë.

treguesi	Cotton	Cotton Eco	Synthetics
––––– 1)	■	■	■
––––	■	■	■
–––	■	■	■
––	■	■	■
–	■	■	■

1) Kohëzgjatja e parazgjedhur për të gjitha programet.

6.13 Start/Pause ▷‖

Shtypni butonin Start/Pause për të filluar, vendosur në pauzë ose ndërprerë një program që është në punë.

7. PROGRAMET

7.1 Tabela e programeve

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia maksimale e rrotullimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit [rpm]	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Cotton 40 °C 90 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200-400)	8 kg	**Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra**. Ndotje normale dhe e madhe.
Cotton Eco[1)] 40 °C 60 °C - 40 °C	1200 rpm (1200-400)	8 kg	**Të pambukta të bardha dhe të pambukta me ngjyra që nuk zbehen**. Ndotje normale. Konsumi i energjisë ulet dhe koha e programit të larjes zgjatet.
Synthetics 40 °C 60 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400)	3 kg	**Artikuj sintetikë ose tekstile të përziera**. Ndotje normale.
Delicate 40 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200-400)	3 kg	**Tekstile delikate të tilla si akrilike, viskoze dhe tekstile të përziera kërkojnë larje më delikate**. Ndotje normale.
Rapid 14 min. 30 °C	800 rpm (800- 400)	1,5 kg	**Artikuj tekstilë sintetikë dhe të përzier**. Artikuj të ndotur pak e artikuj për të rifreskuar.
Rinse	1200 rpm (1200-400)	8 kg	**Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate.** Program për të shpëlarë dhe për të centrifuguar rrobat. Shpejtësia e parazgjedhur e centrifugimit është ajo që përdoret për programet e pambukut. Reduktojeni shpejtësinë e centrifugimit sipas llojit të rrobave. Nëse është e nevojshme, caktoni opsionin Shpëlarje shtesë për të shtuar shpëlarjet. Me një shpejtësi të ulët centrifugimi, pajisja kryen shpëlarje delikate dhe centrifugim të shkurtër.
Drain/Spin	1200 rpm (1200 -400)	8 kg	Për të centrifuguar rrobat dhe për të shkarkuar ujin në kazan. **Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate**.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia maksimale e rrotullimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit [rpm]	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Anti-Allergy 60 °C	1200 rpm (1200 - 400)	8 kg	**Artikuj të bardhë të pambuktë**. Ky program largon mikroorganizmat falë një faze larjeje me temperaturë që mbahet mbi 60°C për disa minuta. Kjo ndihmon në heqjen e mikrobeve, baktereve, mikro-organizmave dhe grimcave. Shtesa e avullit së bashku me një fazë shtesë shpëlarjeje siguron heqjen e mirë të mbetjeve të detergjentit dhe polenit/substancave alergjike, duke e bërë të përshtatshme për lëkura delikate dhe të ndjeshme.
Duvet 40 °C 60 °C - I ftohtë	800 rpm (800 - 400)	3 kg	**Një batanije sintetike, rroba me mbushje, jorganë, xhupa me pupla** dhe artikuj të ngjashëm.
Silk 30 °C	800 rpm (800 - 400)	3 kg	Program special për **rroba mëndafshi dhe sintetike të përziera**.
Wool 40 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200-400)	1,5 kg	**Të leshta që lahen në makinë larëse, të leshta që lahen me dorë dhe tekstile të tjera** me simbolin e kujdesit "larje me dorë"**2)**.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia maksimale e rrotullimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit [rpm]	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Outdoor 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200-400)	2,5 kg **3)** 1 kg **4)**	Mos përdorni zbutës rrobash dhe sigurohuni që kenë mbetur mbetje zbutësi në folenë e detergjentit. **Artikuj sportivë sintetikë.** Ky program është projektuar për të larë butësisht rrobat moderne sportive që përdoren jashtë dhe është gjithashtu i përshtatshëm për rrobat e palestrës, çiklizmit apo vrapimit ose artikuj të ngjashëm. Ngarkesa e rekomanduar e larjes është 2,5 kg. **Tekstile të papërshkueshme nga uji dhe të papërshkueshme nga uji që e lejojnë shkëmbimin e ajrit.** Ky program mund të përdoret gjithashtu si cikël për rikthimin e papërshkueshmërisë së ujit, projektuar veçanërisht për trajtimin e rrobave me shtresë hidrofobike. Për të kryer ciklin e rikthimit të papërshkueshmërisë së ujit, veproni si vijon: • Zbrazeni detergjentin e larjes në folenë II. • Derdhni një restaurues special papërshkueshmërie nga uji për pëlhura në folenë e zbutësit të rrobave të sirtarit. • Pakësoni ngarkesën e rrobave në 1 kg. Për të përmirësuar më tej veprimin e restaurimit të papërshkueshmërisë së ujit, thajini rrobat në një tharëse rrobash duke vendosur programin e tharjes Outdoor (nëse disponohet dhe nëse etiketa e rrobave lejon tharjen në tharëse rrobash).

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia maksimale e rrotullimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit [rpm]	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Denim 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400)	3 kg	**Program special për xhinse me fazë delikate larjeje për të minimizuar zbehjen e ngjyrave dhe shenjat**. Për kujdes më të mirë, rekomandohet një ngarkesë e reduktuar.
UltraWash 30 °C 60 °C - 30 °C	1200 rpm (1200 - 400)	5 kg	**Artikuj të pambuktë**. Program intensiv për të siguruar performancën më të mirë brenda një kohe të shkurtër.

1) Programet standarde për vlerat e konsumit të Etiketës së energjisë. Sipas rregullores 1061/2010, këto programe janë përkatësisht "Programi standard i pambukut me 60°C" dhe "Programi standard i pambukut me 40°C". Ato janë programet më efikase për sa i përket kombinimit të konsumit të energjisë dhe ujit për larje të rrobave të pambukta me ndotje normale.

Temperatura e ujit në fazën e larjes mund të ndryshojë nga temperatura e deklaruar për programin e zgjedhur.

2) Gjatë këtij cikli kazani rrotullohet ngadalë për të garantuar larje delikate. Mund të duket sikur kazani nuk rrotullohet ose nuk rrotullohet siç duhet, por kjo është normale për këtë program.

3) Programi i larjes.

4) Programi i larjes dhe faza e kthimit të papërshkueshmërisë nga uji.

Përshtatshmëria e opsioneve të programit

Program	Spin	– – –	Paralarje	Njolla	Shpëlarje shtesë	E butë Plus	Hekurosje e lehtë	Natë	Shtyrja	Rregulluesi i kohës
Cotton	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Cotton Eco	■	■	■	■	■	■	■		■	■

Program i	Spin	– – –		Paralarje	Njolla	Shpëlarje shtesë	E butë Plus	Hekurosje e lehtë	Natë	Shtyrja	Rregulluesi i kohës
Synthetics	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Delicate	■	■	■	■	■	■	■		■	■	
Rapid 14 min.	■	■	■							■	
Rinse	■	■	■			■				■	
Drain/ Spin	■	■								■	
Anti-Allergy	■	■	■	■	■	■	■			■	
Duvet	■	■					■			■	
Silk	■	■								■	
Wool	■	■	■							■	
Outdoor	■	■	■			■				■	
Denim	■	■	■		■	■	■	■	■	■	
UltraWash	■	■	■			■	■			■	

7.2 Woolmark Apparel Care - Blu



Cikli i larjes për të leshtat në këtë pajisje është miratuar nga The Woolmark Company për larjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën "për larje me dorë" nëse rrobat lahen sipas udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi i kësaj lavatriçeje. Ndiqni udhëzimet e tharjes dhe proceseve të tjera të larjes në etiketën për kujdesin ndaj rrobave. M1511
Simboli Woolmark është markë certifikimi në shumë vende.

8. CILËSIMET

8.1 Sinjalet akustike

Kjo pajisje ka sinjale të ndryshme akustike, që veprojnë kur:

- Aktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Çaktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Prekni butonat (tingull klikimi).
- Bëni përzgjedhjen e gabuar (3 tinguj të shkurtër).
- Programi përfundon (sekuencë tingujsh për rreth 2 minuta).
- Programi ka keqfunksionim (sekuencë tingujsh të shkurtër për rreth 5 minuta).

Për të **çaktivizuar/aktivizuar** sinjalet akustike kur përfundon programi, prekni njëkohësisht butonat I dhe për rreth 2 sekonda. Ekrani shfaqOn/Off

Nëse çaktivizoni sinjalet akustike, ato vazhdojnë të punojnë kur pajisja ka keqfunksionim.

8.2 Bllokimi për fëmijët

Me këtë opsion mund të parandaloni që fëmijët të luajnë me panelin e kontrollit.

- Për ta **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, mbani shtypur butonin derisa **të ndizet/fiket** në ekran.

Pajisja do të kalojë si parazgjedhje te ky opsion pasi e fikni.

Funksioni i bllokimit për fëmijët mund të mos jetë i disponueshëm për pak sekonda pas ndezjes së pajisjes.

9. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që të disponohet energjia elektrike dhe që rubineti i ujit të jetë i hapur.
2. Derdhni 2 litra ujë në folenë e detergjentit të shënuar me II.

Ky veprim aktivizon sistemin e shkarkimit.

3. Derdhni një sasi të vogël detergjenti në folenë e detergjentit të shënuar me II.
4. Vendosni dhe startoni një program për të pambuktat në temperaturën më të lartë pa rroba në kazan.

Kjo do të heqë të gjitha papastërtitë e mundshme nga tamburi dhe kazani.

10. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

10.1 Aktivizimi i pajisjes

1. Futeni spinën në prizën elektrike.
2. Hapeni rubinetin e ujit.
3. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për pak sekonda për të aktivizuar pajisjen.


Bie një tingull i shkurtër.

10.2 Futja e rrobave në pajisje

1. Hapni derën e pajisjes.
2. Shkundini artikujt përpara se t'i vendosni ato brenda pajisjes.
3. Vendosini artikujt në kazan, njërin pas tjetrit.

Mos fusni shumë rroba në kazan.


4. Mbylleni derën mirë.



KUJDES!
Sigurohuni që të mos ngecin rroba mes guarnicionit dhe derës për të shmangur rrezikun e rrjedhjes së ujit dhe dëmtimit të rrobave.

Larja e njollave tepër të ndotura me vaj dhe graso mund të dëmtojë pjesët prej gome të lavatriçes.

10.3 Mbushja me detergjente dhe produkte suplementare




	Dhomëza për fazën e paralarjes, programin e njomjes ose heqjen e njollave.
	Ndarja për fazën e larjes.
	Foleja për solucionet shtesë në trajtë të lëngët (zbutësi i rrobave, ngrirësit).
MAX	Niveli maksimal i sasisë së aditivëve të lëngshëm.
	Ndarësja për detergjentin pluhur ose të lëngshëm.

Gjithmonë zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produkteve të detergjentit, por rekomandojmë që të mos tejkaloni nivelin maksimal të treguar (**MAX**). Kjo sasi garanton rezultatet më të mira në larje.


Pas një cikli larjeje, nëse është e nevojshme, hiqni mbetjet e detergjentit nga foleja e detergjentit.

10.4 Kontrolloni pozicionin e ndarëses të detergjentit

1. Tërhiqeni jashtë kutinë e detergjentit derisa të ndalojë.




2. Shtypeni levën për poshtë për ta hequr kutinë.
3. Për të përdorur detergjent pluhur, ktheni ndarësen për lart.
4. Për të përdorur detergjent të lëngshëm, ktheni ndarësen për poshtë.



Me ndarësen në pozicionin **POSHTË**:

- Mos përdorni detergjent xhelatinoz ose detergjente me lëng të trashë.
- Mos e tejkaloni dozën e detergjentit të lëngshëm që tregohet në ndarje.
- Mos e vendosni fazën e paralarjes.
- Mos e vendosni funksionin e shtyrjes së programit.

5. Matni sasinë e duhur të detergjentit dhe të zbutësit të rrobave.
6. Mbylleni me kujdes kutinë e detergjentit.



Sigurohuni që ndarësja të mos krijojë bllokim kur të mbyllni sirtarin.

10.5 Vendosja e një programi

1. Rrotulloni çelësin e programeve për të zgjedhur programin e dëshiruar të larjes.

Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ pulson.
Ekrani tregon kohëzgjatjen e përafërt të programit.

2. Prekni butonat përkatës për të ndryshuar temperaturën dhe/ose shpejtësinë e centrifugimit.
3. Nëse dëshironi, vendosni një ose më shumë opsione duke prekur butonat përkatës. Treguesit përkatës ndizen në ekran dhe informacioni i dhënë ndryshon përkatësisht.

Nëse **nuk është e mundur** përzgjedhja, bie një sinjal akustik dhe ekrani tregon – – –.

10.6 Nisja e një programi

Prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të filluar programin.
Treguesi përkatës ndalon së pulsuari dhe qëndron i ndezur.
Programi fillon, dera është e bllokuar.

Ekrani shfaq treguesin 🔒.

Pompa e shkarkimit mund të punojë pak përpara se pajisja të mbushet me ujë.

10.7 Nisja e një programi me shtyrje programi

1. Prekni butonin Shtyrja ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës. Në ekran treguesi shfaq ⏲.

2. Prekni butonin Start/Pause ▷‖. Dera e pajisjes kyçet dhe fillon numërimin mbrapsht të shtyrjes së programit. Ekrani shfaq treguesin ⊸▯.
Kur të përfundojë numërimi mbrapsht, programi fillon automatikisht.

Anulimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të anuluar shtyrjen e programit:

1. Shtypni butonin Start/Pause ▷‖ për ta vënë pajisjen në pauzë. Treguesi përkatës pulson.
2. Prekni butonin Shtyrja ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë ▯ dhe treguesi ⏲ të fiket.
3. Shtypni sërish butonin Start/Pause ▷‖ për ta filluar programin menjëherë.

Ndryshimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të ndryshuar shtyrjen e programit:

1. Shtypni butonin Start/Pause ▷‖ për ta vënë pajisjen në pauzë. Treguesi përkatës pulson.
2. Prekni butonin Shtyrja ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës.
3. Shtypni sërish butonin Start/Pause ▷‖ për ta filluar numërimin e ri mbrapsht.

10.8 Dallimi i ngarkesës me Sistemin SensiCare

ⓘ Kohëzgjatja e programit në ekran i referohet një **ngarkese të mesme/të lartë**.

Pas prekjes së butonit Start/Pause ▷‖, fiket treguesi i ngarkesës maksimale të deklaruar, SensiCare System fillon dallimin e ngarkesës së rrobave:

1. Pajisja e dallon ngarkesën brenda 30 sekondave të para. Gjatë kësaj faze shiritat Rregulluesi i kohës ⁻⁻⁻⁻ të vendosura poshtë shifrave të kohës luajnë një animacion të thjeshtë, kazani rrotullohet shkurtimisht.
2. Kohëzgjatja e programit do të rregullohet përkatësisht dhe mund të rritet ose ulet. Pas 30 sekondave të tjera, fillon mbushja me ujë.

Në përfundim të dallimit të ngarkesës, **në rast mbingarkese të kazanit**, treguesi **MAX** pulson në ekran:

Në këtë rast, për 30 sekonda, pajisja mund të vendoset në pauzë dhe mund të hiqen rrobat e tepërta.

Pasi hiqen rrobat e tepërta, prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të nisur sërish programin. Faza SensiCare mund të përsëritet deri në tre herë (shikoni pikën 1).

E rëndësishme! Nëse nuk do të reduktohet sasia e rrobave, programi i larjes fillon gjithsesi, pavarësisht mbingarkesës. Në këtë rast, nuk do të jetë e mundur që të garantohen rezultatet më të mira të larjes.

ⓘ Pas 20 minutash pas nisjes së programit, kohëzgjatja e programit mund të përshtatet sërish në varësi të kapacitetit të thithjes së ujit nga rrobat.

Dallimi me SensiCare kryhet vetëm me programet e plota të larjes dhe nëse kohëzgjatja e programit nuk është reduktuar përmes butonit Rregulluesi i kohës.

10.9 Ndërprerja e programit dhe ndryshimi i opsioneve

Kur programi është në punë, mund të ndryshoni **vetëm disa** opsione:

1. Prekni butonin Start/Pause ▷‖. Treguesi përkatës pulson.
2. Ndrysho opsionet. Informacioni i dhënë në ekran ndryshon përkatësisht.
3. Prekni sërish butonin Start/Pause ▷‖.

Programi i larjes vazhdon.

10.10 Anulimi i një programi në funksionim

1. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për të anuluar programin dhe për të çaktivizuar pajisjen.
2. Shtypni sërish butonin Ndezje/Fikje për ta aktivizuar pajisjen.

Nëse Sistemi SensiCare është kryer dhe ka nisur tashmë mbushja me ujë, programi i ri fillon **pa përsëritur Sistemin SensiCare**. Uji dhe detergjenti nuk shkarkohen për të shmangur shpenzimet. Ekrani shfaq kohëzgjatjen maksimale të programit, duke e përditësuar atë rreth 20 minuta pas nisjes së programit të ri.

Ekziston edhe një mënyrë alternative për anulimin:
1. Rrotullojeni çelësin përzgjedhës në pozicionin "Reset" (Rivendos) • .
2. Pritni për 1 sekondë. Ekrani shfaq ––– .

Tani, ju mund të vendosni një program të ri larjeje.

10.11 Hapja e derës - Shtimi i rrobave

Nëse temperatura dhe niveli i ujit në kazan janë shumë të larta dhe/ose kazani vazhdon të rrotullohet, ju nuk mund ta hapni derën.

Kur një program ose shtyrje programi është në punë, dera e pajisjes është e kyçur.

1. Prekni butonin Start/Pause ▷‖. Në ekran fiket treguesi përkatës i bllokimit të derës.
2. Hapni derën e pajisjes. Nëse është e nevojshme, shtoni ose hiqni artikujt.
3. Mbyllni derën dhe shtypni butonin Start/Pause ▷‖.

Vazhdon programi ose shtyrja e programit.

10.12 Përfundimi i programit

Kur programi të ketë përfunduar, pajisja fiket automatikisht. Sinjalet akustike funksionojnë, (nëse janë aktive). Ekrani shfaq 0:00

Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ fiket.

Dera zhbllokohet dhe treguesi 🔒 fiket.

1. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për të çaktivizuar pajisjen.

Pesë minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.

Kur e aktivizoni pajisjen përsëri, ekrani tregon fundin e programit të mëparshëm. Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

2. Nxirrni nga pajisja rrobat.
3. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.
4. Mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur, për të parandaluar mykun dhe erërat e pakëndshme.
5. Mbyllni rubinetin e ujit.

10.13 Shkarkimi i ujit pas përfundimit të ciklit

Nëse keni zgjedhur një program ose një opsion që nuk e zbraz ujin e shpëlarjes së fundit, programi përfundon, por:

- Zona e kohës shfaq 0:00 dhe ekrani shfaq derën e kyçur.
- Kazani vazhdon të rrotullohet me intervale të rregullta për të parandaluar rrudhat te rrobat.
- Dera qëndron e bllokuar.
- Për të hapur derën duhet të shkarkoni ujin:

1. Nëse është e nevojshme, prekni butonin Centrifugimi për të ulur shpejtësinë e centrifugimit të propozuar nga pajisja.
2. Shtypni butonin Start/Pause:
   - Nëse keni vendosur Ndërprerje e shpëlarjes, pajisja shkarkon ujin dhe kryen centrifugimin.
   - Nëse keni vendosur Natë, pajisja vetëm shkarkon ujin

Treguesi i opsionit Ndërprerje e shpëlarjes dhe Natë zhduket.

3. Kur programi të ketë përfunduar dhe treguesi i bllokimit të derës të fiket, ju mund ta hapni derën.
4. Shtypni butonin Ndezje/Fikje për pak sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

10.14 Opsioni i Pritjes aktive

Funksioni i gatishmërisë çaktivizon automatikisht pajisjen për të ulur konsumimin e energjisë kur:

- Nuk e përdorni pajisjen për 5 minuta . Shtypni butonin Ndezje/Fikje për ta aktivizuar pajisjen sërish.
- 5 minuta pas përfundimit të programit të larjes
  Shtypni butonin Ndezje/Fikje për ta aktivizuar pajisjen sërish.
  Ekrani tregon përfundimin e programit të fundit.
  Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

Nëse çelësi rrotullohet në pozicionin "Reset" (Rivendosja) , pajisja fiket automatikisht pas 30 sekondash.

Nëse vendosni një program ose opsion që përfundon me ujë në kazan, funksioni i gatishmërisë **nuk çaktivizon** pajisjen për t'ju kujtuar të shkarkoni ujin.

11. UDHËZIME DHE KËSHILLA

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

11.1 Ngarkesa e rrobave

- Ndani rrobat në: të bardha, me ngjyra, sintetike, delikate dhe të leshta.
- Zbatoni udhëzimet e larjes në etiketat e kujdesit te rrobat.
- Mos lani së bashku rrobat e bardha dhe ato me ngjyrë.
- Disa rroba me ngjyra të nxjerrin bojë gjatë larjes së parë. Rekomandojmë që ato të lahen më vete dy-tre herët e para.
- Kopsitni këllëfët e jastëkëve, mbyllni zinxhirët, tokëzat dhe sustat. Lidhini rripat.
- Zbrazni xhepat dhe shpalosni rrobat.
- Kthejini së prapthi rrobat me disa shtresa, të leshtat dhe veshjet me stampa.
- Trajtoni paraprakisht njollat e vështira.
- Lajini njollat e vështira me detergjent të veçantë.
- Bëni kujdes me perdet. Hiqini kapëset e tyre dhe futini perdet në një qese për larje apo këllëf jastëku.
- Mos lani rroba pa tegela ose me prerje.
- Përdorni një trastë larjeje për të larë rroba të vogla dhe/ose delikate (p.sh. sytjena me tela, rripa, streçe etj.).
- Një ngarkesë shumë e vogël mund të shkaktojë probleme balancimi gjatë fazës së centrifugimit duke çuar në dridhje të tepërta. Nëse ndodh kjo:

a. ndërprisni programin dhe hapni derën (referojuni kapitullit "Përdorimi i përditshëm");
b. rishpërndajeni me dorë ngarkesën në mënyrë që rrobat të shpërndahen njëtrajtësisht nëpër kazan;
c. shtypni butonin Start/Pause. Faza e centrifugimit vazhdon.

11.2 Njollat e vështira

Për disa njolla, nuk mjafton uji dhe detergjenti.

Rekomandojmë që këto njolla t'i trajtoni përpara se të vendosni rrobat në pajisje.

Për këtë ka heqës të veçantë njollash. Përdorni heqës të veçantë njollash që i përshtaten llojit të njollës dhe pëlhurës.

11.3 Detergjentet dhe trajtimet e tjera

- Përdorni vetëm detergjente dhe trajtime të tjera të prodhuara posaçërisht për lavatriçe:
  - detergjentet në trajtë pluhuri për të gjitha llojet e rrobave, duke përfshirë delikatet. Preferohen detergjente pluhur që përmban zbardhues për higjienizimin e të bardhave dhe rrobave të palara
  - detergjentet në trajtë lëngu, mundësisht për programe me temperatura të ulëta (60 °C maksimumi) për të gjitha llojet e rrobave ose të posaçme vetëm për të leshtat.
- Mos i përzieni llojet e ndryshme të detergjenteve.
- Për të ndihmuar mjedisin, mos përdorni më shumë detergjent sesa sasia e rekomanduar.
- Ndiqni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i detergjenteve ose trajtimeve tò tjera pa tejkaluar nivelin e treguar maksimal (**MAX**).
- Përdorni detergjentet e rekomanduara për llojin dhe ngjyrën e pëlhurës, programin, temperaturën dhe nivelin e ndotjes.

11.4 Këshilla ekologjike

- Vendosni një program pa fazën e paralarjes për të larë rroba me ndotje normale.
- Gjithmonë fillojeni një program larjeje me ngarkesën maksimale të lejuar të rrobave.
- Nëse përdorni trajtimin paraprak të njollave ose përdorni një heqës njollash, vendosni një program me temperaturë të ulët.
- Që të përdorni sasinë e duhur të detergjentit, kontrolloni fortësinë e ujit në sistemin tuaj hidraulik. Referojuni paragrafit "Fortësia e ujit".

11.5 Fortësia e ujit

Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni zbutës uji për lavatriçe. Në zonat ku uji është i butë nuk nevojitet përdorimi i zbutësit të ujit.

Kontaktoni me autoritetet lokale të ujësjellësit për të mësuar fortësinë e ujit.

Përdorni sasinë e duhur të zbutësit të ujit. Zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

12. KUJDESI DHE PASTRIMI

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

12.1 Pastrimi i jashtëm

Pastrojeni pajisjen vetëm me ujë të ngrohtë dhe sapun të butë. Thajini plotësisht të gjitha sipërfaqet.

KUJDES!
Mos përdorni alkool, tretës boje ose produkte kimike.

KUJDES!
Mos pastroni sipërfaqet metalike me detergjent me bazë klori.

12.2 Heqja e çmërsit

Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni produkt zbutjeje uji për lavatriçe.

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të kontrolluar për çmërs.

Detergjentet standarde përmbajnë agjentë për zbutjen e ujit, por rekomandojmë që herë pas here të vini në punë një cikël me kazan bosh dhe një produkt kundër çmërsit.


Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

12.3 Larja e mirëmbajtjes

Përdorimi i përsëritur dhe i zgjatur i programeve me temperaturë të ulët mund të shkaktojë depozitime të detergjenteve, mbetje pushi, rritje të baktereve brenda kazanit. Kjo mund të krijojë aroma të këqija dhe myk. Për të eliminuar depozitimet dhe për të pastruar pjesën e brendshme të pajisjes, aplikoni një larje mirëmbajtjeje rregullisht (të paktën një herë në muaj).

Referojuni kapitullit "Pastrimi i kazanit".

12.4 Guarnicioni i derës



Kontrolloni rregullisht guarnicionin dhe hiqni të gjitha objektet nga pjesa e brendshme.

12.5 Pastrimi i kazanit

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të parandaluar formimin e ndryshkut.

Pastroni kazanin me produkte speciale për çelik inoks.

Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

Për pastrim të plotë:


- Nxirrni të gjitha rrobat nga kazani.
- Zgjidhni programin Të pambuktat me temperaturën më të lartë
  Shtoni një sasi të vogël detergjenti pluhur në kazanin bosh, për të shpëlarë mbetjet që mund të mbetur.

Ndonjëherë, në përfundim të një cikli ekrani mund të shfaqë ikonën ⁘ Ky është rekomandim për të kryer një "pastrim të kazanit".


12.6 Pastrimi i sirtarit të detergjentit

Për të parandaluar depozitimet e mundshme të detergjenteve të thara apo zbutësit të rrobave dhe/ose formimin e mykut në sirtarin e detergjentit, herë pas here kryeni procedurën e mëposhtme të pastrimit:


1. Hapni sirtarin. Shtypni kapësen poshtë siç tregohet në figurë dhe tërhiqeni.




2. Hiqni pjesën e sipërme të folesë së aditivit për të ndihmuar pastrimin dhe për ta larë në ujë të rrjedhshëm të ngrohtë, për të hequr gjurmët e detergjentit të akumuluar. Pas pastrimit, vendoseni sërish pjesën e sipërme në vendin e vet.



3. Sigurohuni që të gjitha mbetjet e detergjentit të hiqen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme e folesë. Përdorni një furçë të vogël për të pastruar folenë.



4. Futeni sirtarin e detergjentit në udhëzuesit e vet dhe mbylleni. Vini në punë një program shpëlarjeje pa rroba në kazan.



12.7 Pastrimi i pompës së shkarkimit

Kontrolloni rregullisht filtrin e pompës së shkarkimit dhe sigurohuni që të jetë e pastër.

Pastrojeni pompën e shkarkimit nëse:


- Pajisja nuk e shkarkon ujin.
- Kazani nuk rrotullohet.
- Pajisja bën një zhurmë të pazakontë për shkak të bllokimit të pompës së shkarkimit.
- Në ekran shfaqet kodi i alarmit E20


PARALAJMËRIM!


- Hiqni spinën nga priza elektrike.
- Mos e hiqni filtrin gjatë kohës që pajisja është në punë.
- Mos e pastroni pompën nëse uji në pajisje është i nxehtë. Prisni derisa uji të ftohet.
- Përsëritni hapin 3 disa herë duke mbyllur dhe hapur valvulën derisa uji të ndalojë daljen.


Mbani gjithmonë një leckë pranë për të fshirë çdo rrjedhje uji gjatë heqjes së filtrit.


Vazhdoni si më poshtë për të pastruar pompën:


1.



2.



3.


4.


5.


6.



7.



8.



PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që helika e pompës të mund të rrotullohet. Nëse nuk rrotullohet, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit. Sigurohuni gjithashtu që filtri të jetë shtrënguar mirë për të shmangur rrjedhjet.


Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:
1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

12.8 Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës









12.9 Shkarkimi i emergjencës

Nëse pajisja nuk mund ta shkarkojë ujin, kryeni të njëjtën procedurë që përshkruhet në paragrafin "Pastrimi filtrit të shkarkimit". Nëse është e nevojshme, pastroni pompën.

Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

12.10 Masat paraprake të parandalimit të brymës

Nëse pajisja është e instaluar në një zonë ku temperatura mund të arrijë vlera rreth 0° C ose të bjerë më poshtë, hiqni ujin e mbetur nga tubi i hyrjes së ujit dhe pompa e shkarkimit.

1. Hiqni spinën nga priza elektrike.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.
3. Vendosni dy skajet e tubit të hyrjes së ujit në një enë dhe lëreni ujin të rrjedhë nga tubi.
4. Zbrazni pompën e shkarkimit. Referojuni procedurës së shkarkimit të emergjencës.

5. Kur pompa e shkarkimit të jetë e zbrazur, vendosni përsëri tubin e hyrjes së ujit.

PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që temperatura të jetë më e lartë se 0 °C përpara se ta përdorni sërish pajisjen.
Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga temperaturat e ulëta.

13. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

13.1 Hyrje


Pajisja nuk ndizet ose ndalon gjatë punës.

Së pari, përpiquni të gjeni një zgjidhje për problemin (referojuni tabelës). Nëse problemi vazhdon, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

Në rast problemesh të mëdha, bien sinjalet akustike, ekrani tregon një kod alarmi dhe butoni Start/Pause ▷‖ **mund të pulsojë në mënyrë të vazhdueshme:**

- E 10 - Pajisja nuk mbushet mirë me ujë. Niseni pajisjen sërish duke shtypur butonin Start/Pause ▷‖. Pas 5 sekondash, dera do të zhbllokohet.
- E20 - Pajisja nuk e shkarkon ujin.
- E40 - Dera e pajisjes është e hapur ose nuk është mbyllur mirë. Ju lutemi kontrolloni derën!

Nëse pajisja është e mbingarkuar, hiqni disa artikuj nga kazani dhe/ose mbani mbyllur derën ndërsa prekni butonin Start/Pause ▷‖ derisa treguesi 🔒 të ndalojë së pulsuari (shikoni figurën më poshtë).



- EH0 - Furnizimi me rrymë është i paqëndrueshëm. Prisni derisa furnizimi me rrymë të bëhet i qëndrueshëm.
- E91 - Nuk ka komunikim ndërmjet elementeve elektronike të pajisjes. Fikeni dhe ndizeni sërish. Programi nuk ka përfunduar siç duhet ose pajisja ka ndaluar shumë herët. Nëse shfaqet sërish kodi i alarmit, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.

PARALAJMËRIM!
Çaktivizojeni pajisjen përpara se të kryeni ndonjë kontroll.

13.2 Defektet e mundshme

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Programi nuk fillon.	• Sigurohuni që spina të jetë futur në prizë. • Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë e mbyllur. • Sigurohuni që kutia e siguresave të mos ketë ndonjë siguresë të prishur. • Sigurohuni që Start/Pause të jetë prekur. • Nëse caktohet vonesa në nisje e programit, anulojeni cilësimin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Çaktivizoni funksionin e bllokimit për fëmijët, nëse është i ndezur. • Kontrolloni pozicionin e çelësit në programin e përzgjedhur.
Pajisja nuk mbushet mirë me ujë.	• Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetet vendase të ujësjellësit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e furnizimit me ujë të mos jetë e përdredhur, e dëmtuar ose e përthyer. • Sigurohuni që lidhja e zorrës së hyrjes së ujit të jetë e saktë.
Pajisja mbushet me ujë dhe e shkarkon atë menjëherë	• Sigurohuni që zorra e shkarkimit të jetë në pozicionin e duhur. Zorra mund të jetë pozicionuar shumë poshtë. Shihni kapitullin "Udhëzime instalimi".
Pajisja nuk e shkarkon ujin.	• Sigurohuni që tubi lidhës i lavamanit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e shkarkimit të mos jetë e përdredhur ose e përthyer. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Referojuni kapitullit "Kujdesi dhe pastrimi". • Sigurohuni që lidhja e zorrës së shkarkimit të jetë e saktë. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni programin pa fazën e shkarkimit. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni një opsion që përfundon me ujë në kazan.
Faza e centrifugimit nuk funksionon ose cikli i larjes zgjat më shumë sesa zakonisht.	• Vendosni programin e centrifugimit. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Referojuni kapitullit "Kujdesi dhe pastrimi". • Rregulloni me dorë artikujt brenda kazanit dhe niseni sërish fazën e centrifugimit. Ky problem mund të shkaktohet nga probleme ekuilibri.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Ka rrjedhur ujë në dysheme.	• Sigurohuni që bashkueset e zorrëve të ujit të jenë shtrënguar fort dhe që nuk ka rrjedhje uji. • Sigurohuni që zorra e hyrjes së ujit dhe zorra e shkarkimit të mos kenë dëmtime. • Sigurohuni që të përdorni detergjentin e duhur dhe sasinë e duhur të tij.
Dera e pajisjes nuk mund të hapet.	• Sigurohuni që të jetë zgjedhur një program larjeje që përfundon me ujë në kazan. • Sigurohuni që programi i larjes ka përfunduar. • Vendosni programin e shkarkimit ose të centrifugimit nëse ka ende ujë në kazan. • Sigurohuni që pajisja furnizohet me energji. • Ky problem mund të shkaktohet nga një defekt i pajisjes. Kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.
Pajisja bën një zhurmë të pazakontë dhe dridhet.	• Sigurohuni që nivelimi i pajisjes është i saktë. Shihni kapitullin "Udhëzime instalimi". • Sigurohuni që të keni hequr paketimin dhe/ose bulonat e transportit. Shihni kapitullin "Udhëzime instalimi". • Shtoni më shumë rroba në kazan. Ngarkesa mund të jetë tepër e vogël.
Kohëzgjatja e programit ngrihet ose ulet gjatë punës së programit.	• Sistemi SensiCare është në gjendje të përshtatë kohëzgjatjen e programit sipas llojit dhe sasisë së rrobave. Referojuni paragrafit "Dallimi i ngarkesës me Sistemin SensiCare" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".
Rezultatet e larjes nuk janë të kënaqshme.	• Shtoni sasinë e detergjentit ose përdorni një lloj tjetër. • Përdorni produkte të veçanta për të hequr njollat e vështira përpara se të lani rrobat. • Sigurohuni që të vendosni temperaturën e duhur. • Pakësoni ngarkesën e rrobave.
Ka shumë shkumë në kazan gjatë ciklit të larjes.	• Reduktoni sasinë e detergjentit.
Pas ciklit të larjes, ka ende mbetje detergjenti në sirtarin e detergjentit.	• Sigurohuni që fleta të jetë në pozicionin e duhur (LART për detergjent pluhur - POSHTË për detergjent të lëngshëm). • Sigurohuni që ta përdorni folenë e detergjentit sipas këshillave që jepen në këtë manual përdorimi.

Pas kontrollit, aktivizojeni pajisjen. Programi vazhdon nga pika e ndërprerjes.
Nëse problemi ndodh përsëri, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.
Nëse ekrani shfaq kode të tjera alarmi, çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen. Nëse problemi vazhdon, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

14. VLERAT E KONSUMIT

Vlerat e deklaruara janë marrë në kushte laboratorike me standardet përkatëse. Shkaqe të ndryshme mund të ndryshojnë të dhënat: sasia dhe lloji i rrobave për larje dhe temperatura e ambientit. Gjithashtu në kohëzgjatjen e programit të larjes mund të ndikojë edhe presioni i ujit, tensioni i furnizimit dhe temperatura e ujit në hyrje.

Specifikimet teknike mund të ndryshojnë pa dhënë njoftim paraprak për të përmirësuar cilësinë e produktit.

Programet	Ngarkesa (kg)	Konsumi i energjisë (kWh)	Konsumi i ujit (litra)	Kohëzgjatja e përafërt e programit (minuta)	Lagështia e mbetur (%)[1]
Cotton 60°C	8	1,40	75	210	53
Cotton 40°C	8	1,00	75	210	53
Synthetics 40°C	3	0,60	56	140	35
Delicate 40°C	3	0,50	59	90	35
Wool 30°C	1,5	0,40	62	75	30
Programet standarde të pambukut					
Program standard për pambukun 60°C	8	0,58	52	257	53
Program standard për pambukun 60°C	4	0,37	37	234	53
Program standard për pambukun 40°C	4	0,34	38	230	53

[1] Në fund të fazës së centrifugimit.

Modaliteti fikur (W)	Modaliteti lënë ndezur (W)
0.30	0.30

Informacionet e dhëna në tabelën më lart janë në përputhje me direktivën implementuese 2009/125/EC të rregullores 1015/2010 të Komisionit të BE-së.

15. TË DHËNAT TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia / Lartësia / Thellësia / Thellësia totale	600 mm/ 850 mm/ 547 mm/ 600 mm

Lidhja elektrike	Tensioni Fuqia totale Siguresa Frekuenca	230 V 2200 W 10 A 50 Hz
Niveli i mbrojtjes ndaj hyrjes së grimcave të ngurta dhe lagështisë sigurohet nga kapaku mbrojtës, përveç rastit kur pajisja me tension të ulët nuk ka mbrojtje kundër lagështisë		IPX4
Presioni i furnizimit me ujë	Minimumi Maksimumi	0,5 bar (0,05 MPa) 8 bar (0,8 MPa)
Furnizimi me ujë [1)]		Ujë i ftohtë
Ngarkesa maksimale	Pambuk	8 kg
Kategoria e efikasitetit energjetik		A+++ -40%
Shpejtësia e centrifugimit	Maksimumi	1200 rpm

[1)] Lidheni zorrën e hyrjes së ujit me një rubinet me filetim 3/4" .

16. AKSESORËT


16.1 Grupi i pllakës fiksuese (4055171146)

I disponueshëm nga shitësi i autorizuar.

Nëse e instaloni pajisjen mbi plintë, sigurojeni në pllakat fiksuese.

Lexoni me kujdes manualin e ofruar bashkë me aksesorët.

16.2 Pajisja ndihmëse



Tharësja e rrobave mund të vendoset mbi një lavatriçe **vetëm duke përdorur setin e duhur të stivimit të prodhuar dhe të miratuar nga ELECTROLUX**.


Verifikoni setin e përputhshëm të stivimit duke kontrolluar thellësinë e pajisjeve tuaja.

Seti i stivimit mund të përdoret vetëm me pajisjet e specifikuara në fletëpalosjen që jepet me aksesorin.

Lexoni me kujdes manualin e ofruar bashkë me pajisjen dhe aksesorin.

PARALAJMËRIM!
Mos e vini tharësen poshtë lavatriçes.

16.3 Bazament me sirtar



Për të ngritur pajisjen dhe për ta bërë mbushjen dhe zbrazjen e pajisjes më të lehtë.

Sirtari mund të përdoret për futjen e rrobave p.sh.: peshqirë, produkte pastrimi e të tjera.

Lexoni me kujdes manualin e ofruar bashkë me aksesorët.

16.4 E disponueshme në www.electrolux.com/shop ose nga shitësi i autorizuar

Vetëm aksesorët e duhur të miratuar nga ELECTROLUX sigurojnë standardet e sigurisë së pajisjes. Nëse përdoren pjesë të pamiratuara, çdo pretendim do të shfuqizohet.

17. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop



192939760-A-492017

CE